 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar ipe dt.	29.12.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-676/A



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

Ruga e Shkronjave Nr. 1, 20000  
Prizren, Republika e Kosovës,  
Tel:+381 (0) 29- 232 140;  
Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

**RREGULLORE PËR SHKOLLËN VERORE**  
**NDËRKOMBËTARE**

Prizren, Dhjetor 2022



Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 42 dhe 47-të, të Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren (tutje referuar si Universiteti), në mbledhjen e mbajtur më datë: 27.12.2022, Senati i këtij Universiteti e miratoi:

## **Rregulloren për Shkollën Verore Ndërkombëtare**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore përkufizohet baza ligjore për themelimin dhe funksionimin e Shkollës Verore Ndërkombëtare në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren (tutje referuar si ISSP), emërtimi i së cilës në gjuhën angleze është, “International Summer School Prizren (ISSP)”. Kjo Rregullore definon, dhe përkufizon misionin, vizionin, organizimin, fushëveprimtarinë, funksionet, përgjegjësitë, kompetencat dhe detyrat e Shkollës Verore Ndërkombëtare.

### **Misioni dhe vizioni i Shkollës Verore Ndërkombëtare**

#### **Neni 2**

##### **Misioni i Shkollës Verore Ndërkombëtare**

Misioni i ISSP, është që të promovojë dhe zhvilloj vlerat akademike dhe hulumtuese të Universitetit, si dhe ato të trashëgimisë kulturore të rajonit në të cilin vepron, në kohezion me nevojat për mobilitet të studentëve, të stafit akademik, shkëmbim të përvojave të hulumtimit, avancim të procesit të rrjetëzimit ndërkombëtar dhe rritje të diversitetit ndërkulturor.

#### **Neni 3.**

##### **Vizioni i Shkollës Verore Ndërkombëtare**

Vizioni i ISSP është që ta shfrytëzojë potencialin e saj lidhur me diversitetin e mjedisit akademik, historik, turistik, kulturor, fetar dhe lingual në funksion të ndërtimit të një qendre rajonale të bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe mobilitetit akademik. Në planin afatgjatë, nëpërmjet kapaciteteve të Shkollës Verore Ndërkombëtare, Universiteti mëton të shndërrohet në një qendër Evropiane të mobilitetit akademik, me theks të veçantë në fushat e teknologjisë informative, biznesit ndërkombëtar, agrobiznesit, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit bashkëkohor të edukimit, gjuhësisë dhe albanologjisë si dhe të drejtës ndërkombëtare.



#### **Neni 4.**

##### **Struktura organizative e Shkollës Verore Ndërkombëtare**

1. Senati i Universitetit, me qëllim të organizimit sa më të mirë të ISSP, çdo vit në muajin janar do të themelojë një Këshill Organizativ të ISSP;
2. Këshilli Organizativ do të ketë në përbërje 7 (shtatë) anëtarë.
3. Struktura e Këshillit Organizativ do të përbëhet nga:
  - a) 3 (tre) anëtarë të stafit akademik të Universitetit;
  - b) 1 (një) anëtar i stafit administrativ të Universitetit;
  - c) 1 (një) anëtar nga stafi akademik përfaqësues të Universiteteve partnere;
  - d) 1 (një) anëtar nga parlamenti studentor, dhe
  - e) 1 (një) anëtar përfaqësues i shoqërisë civile.
- 3.1 Kryesuesi i Këshillit Organizativ është koordinatori dhe është anëtar me të drejtë vote.
- 3.2 Vendimet e Këshillit Organizativ merren me shumicë të votav të anëtarëve, përjashtimisht kur votimi është i barbartë vota e kryesuesit është vendimtare.
4. Senati i Universitetit, e emëron çdo vit koordinatorin e Shkollës Verore Ndërkombëtare.
5. Koordinatorit të Shkollës Verore Ndërkombëtare do t'i ofrohet mbështetje dhe përkrahje e plotë, duke pëfshirë kapacitetet e stafit administrativ dhe infrastrukturës së Universitetit, në funksion të organizimit dhe mbarëvajtjes së suksesshme të Shkollës Verore Ndërkombëtare.
6. Këshilli Organizativ dhe Koordinatorin i Shkollës Verore Ndërkombëtare janë përgjegjës për organizimin e aktiviteteve brenda kësaj Shkolle Verore.
7. Këshilli Organizativ e harton Udhëzuesin për studentët si dhe dokumentet tjera të Shkollës Verore Ndërkombëtare.
8. Për mënyrën e pagesës së personelit të Këshillit Organizativ dhe të angazhuarëve tjerë vendos me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

#### **Neni 5.**

##### **Përgjegjësitë e organizimit të moduleve të Shkollës Verore Ndërkombëtare**

1. ISSP ofron module apo kurse intensive në formë të ligjëratave dhe ushtrimeve, në kohëzgjatje prej dy javësh. Modulet propozohen nga Këshilli Organizativ dhe miratohen nga Senati pas konsultimit me njësitë akademike të Universitetit. Modulet apo kurset ofrohen nga njësitë akademike të listuara si më poshtë:



- a) Fakulteti i Shkencave Kompjuterike;
  - b) Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit;
  - c) Fakulteti i Edukimit;
  - d) Fakulteti i Ekonomisë;
  - e) Fakulteti Juridik;
  - f) Fakulteti i Filologjisë.
2. Modulet e ISSP mbahen dhe ligjërohen nga mentor të jashtëm dhe komentor të brendshëm.

### **Neni 6.**

#### **Procedura e aplikimit të studentëve pjesëmarrës në Shkollën Verore Ndërkombëtare**

1. Studentët duhet të jenë të regjistruar në një institucion të arsimit të lartë;
2. Studentët për pranim në ISSP duhet të zotërojnë gjuhën angleze.
3. Studentët duhet të shprehin interesin e tyre për modulin (kursin).
4. Studentët duhet të dorëzojnë një CV, dhe dokumentet përcjellëse me aplikacionin e tyre në internet në platformën online. Me plotësimin e aplikacionit dhe përzgjedhjen e modulit, studentit konfirmon se i ka lexuar dhe pranuar rregullat e pjesëmarrjes në ISSP.
5. Studentët mund të aplikojnë për modulin (kursin), vetëm përmes formularit elektronik në ueb-faqen e Universitetit.
6. Formulari i aplikimit do të jetë i qasshëm për studentët në ueb-faqen e Universitetit.
7. Aplikimet e studentëve për modulet miratohen/refuzohen nga Këshilli Organizativ i ISSP. Këshilli Organizativ e rezervon të drejtën për të mohuar mundësinë e hyrjes në një modul, në rast se studentit aplikant nuk i plotëson kërkesat e pranimit.
8. Lista përfundimtare e studentëve të pranuar/refuzuar miratohet në Senat të Universitetit.
9. Studentët janë të obliguar të marrin pjesë rregullisht në ligjëratat dhe ushtrimet e moduleve, gjatë periudhës së mbajtjes së ISSP.

### **Neni 7.**

#### **Të drejtat dhe obligimet e studentëve pjesëmarrës**

1. Pas përfundimit të suksesshëm të modulit, studentit pjesëmarrës do të pajiset me një certifikatë (me ECTS) si rezultat i përfundimit me sukses të modulit.



2. Studentëve pjesëmarrës u sigurohen të gjitha lehtësirat e nevojshme gjatë periudhës së ISSP.
3. Procesi i njohjes së ECTS've realizohet në përputhje me Neni 3 të Rregullores për transferimin e studimeve në Universitetin "UKSHIN HOTI" Prizren.
4. Studentët kanë mundësinë të shfrytëzojnë bibliotekën e Universitetit, kabinetet e informatikës, laboratorët dhe resurset tjera të Universitetit.
5. Studentët e Universiteteve të tjera brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës kanë të drejtë të marrin pjesë në ISSP, dhe t'i gëzojnë të gjitha të drejtat.
6. Studentët pjesëmarrës obligohen që të respektojnë të gjitha rregulloret e zbatueshme për Universitetin.
7. Këshilli Organizativ i ISSP rezervon të drejtën të përjashtojë çdo student pjesëmarrës i cili nuk i respekton Kodin e Etikës dhe rregulloret e zbatueshme të Universitetit.

#### **Neni 8.**

##### **Përzgjedhja e mentorëve/komentorëve për modulet e Shkollës Verore Ndërkombëtare**

1. Këshilli Organizativ i ISSP e hap thirrjen publike për aplikim të mentorëve dhe komentorëve, bazuar në autorizimet e Senatit dhe Këshillit Drejtues.
2. Senati merr vendim për themelimin e Këshillit Organizativ të ISSP ndërsa Këshilli Drejtues e miraton buxhetit sipas propozimit të Këshillit Organizativ.
3. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes përcaktohen nga Këshilli Organizativ.
4. Periudha dhe afati kohor i aplikimit të kandidatëve për mentor/komentor përcaktohet nga Këshilli Organizativ, dhe duhet të zgjatë jo më pak se 15 ditë kalendarik.

#### **Neni 9.**

##### **Përzgjedhja e stafit mbështetës dhe studentëve të angazhuar**

1. Rektori i Universitetit dhe Sekretari i Përgjithshëm kujdesen për angazhimin e stafit të nevojshëm për ISSP.
2. Këshilli Organizativ themelon komisionin profesional për intervestimin e kandidatëve për studentët e angazhuar.
3. Përzgjedhja e studentëve të angazhuar për nevojat e ISSP bëhet nëpërmjet thirrjes publike sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Organizativ, me propozim të Këshillit Organizativ dhe me miratim përfundimtar të Senatit të Universitetit.



## **Neni 10.**

### **Aktivitetet tjera**

1. Këshilli Organizativ do të organizojë edhe aktivitete tjera gjatë periudhës së organizimit të ISSP. Ndër të tjera mund të organizohen:
  - a) tryeza të rrumbullakëta,
  - b) punëtori tematike;
  - c) vizita studimore;
  - d) ligjërata të hapura me personalitete të rëndësishme publike;
  - e) promovime të librave dhe punimeve artistike; dhe,
  - f) aktivitete tjera artistike, kulturore, dhe sportive.

## **Neni 11.**

### **Tarifat e pjesëmarrjes dhe financimi i Shkollës Verore Ndërkombëtare**

1. Tarifat e pjesëmarrjes në ISSP përcaktohen çdo vit me propozim të Senatit dhe miratim të Këshillit Drejtues të Universitetit.
2. Pjesëmarrësit në ISSP marrin përsipër të gjitha kostot që lidhen me pjesëmarrjen e tyre në ISSP, përfshirë këtu shpenzimet e akomodimit, udhëtimit, sigurimit shëndetësor, sigurimit të udhëtimit, ushqimit etj, nëse nuk vendoset ndryshe nga Senati dhe Këshilli Drejtues.
3. Buxheti për organizmin dhe mbarëvajtjen e ISSP përcaktohen çdo vit me vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit. Planifikimin e buxhetit e bënë Këshilli Organizativ në bashkëpunim me menaxhmentin e Universitetit.
4. ISSP ka të drejtë të pranojë donacione dhe përkrahje financiare nga organizatat qeveritare, jo-qeveritare, private, vendore dhe ndërkombëtare.
5. Pranimi i donacioneve dhe përkrahjeve tjera financiare dhe materiale përcaktohet në bazë të marrëveshjeve me donatorët.

## **Neni 12.**

### **Periudha e organizimit të Universitetit Veror Ndërkombëtar**

1. ISSP organizohet në intervalin kohor qershor - shtator të çdo viti, nëse nuk përcaktohet ndryshe me vendim të veçantë nga Senati.



2. Kalendari i saktë i organizimit të ISSP përcaktohet nga Senati i Universitetit, në bashkëpunim me partnerët akademik, dhe palët tjera të interesit.

#### Neni 13.

#### Për çështjet që nuk parashihen në Rregullore



1. Për çështje tjera që nuk janë të përcaktuara në këtë Rregullore, vendoset sipas rekomandimit të Këshillit Organizativ dhe me miratim të Senatit/Këshillit Drejtues varësisht nga përgjegjësia.

#### Neni 14.

#### Ndryshimi, hyrja në fuqi dhe zbatimi

2. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati i Universitetit.
3. Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet rregullorja paraprake të kësaj natyre.
4. Kjo Rregullore mund të plotësohet, dhe ndryshohet me kërkesën e Rektorit dhe me miratimin nga ana e Senatit të Universitetit.

Kryesues i Senatit të Universitetit

Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj